

## Procesverbal

*Nga mbledhja e I - (parë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash, e mbajtur më datë: 08.02.2023*

### *Rend Dite*

- 1) Miratimi i procesverbalit nga seanca XII e vitit 2022,
- 2) Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2022 dhe Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2023,
- 3) Propozim-vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Komunën e Skënderajt,
- 4) Rishqyrtimi i Vendimit për ndryshimin e qëllimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore P-70604016-00773-0, ZK ZGATAR, dhe
- 5) Eventuale.

**Uran Halimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm, mirë se keni ardhë në takimin e parë për vitin 2023! Siç jeni të njoftum edhe me rendin e ditës, mirëpo para se të fillojmë këtë seancë, unë ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje për m' i nderue viktimat e kaosit në Turqi edhe Siri, të shkaktuara nga tërmeti i cili ndodhi para pak ditësh. Ju ftoj për një minutë heshtje! Lavdi! Atëherë vazhdojmë me mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ku njëherit është propozuar ky rend i ditës. Sipas njoftimit që e keni marrë, edhe materialit përmes e-mailit, e dimë që si pikë e parë në këtë rend të ditës është miratimi i procesverbalit nga seanca e XII e vitit 2022. Pika e dytë është Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2022 dhe Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2023, pika e tretë është Propozim-vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Komunën e Skënderajt, edhe kjo komunë e cila pak më herët është goditur nga vërshimet. Vazhdojmë me pikën e katërt, është Rishqyrtimi i Vendimit për ndryshimin e qëllimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore P-70604016-00773-0, ZK ZGATAR. Pika e pestë dhe e fundit është pika eventuale. Gjithashtu, nga propozimet e djeshme, kemi propozimin e zotit Qamil Kolloni, i cili rekomandon për mosngritjen e vlerës së tatimit në pronë. Gjithashtu e kemi edhe një propozim nga kolegu ynë nga radhët e PDK-së, Artan Loshaj, i cili ka kërkuar që të futet si pikë e rendit të ditës, organizimi...në Plan në fakt, në Planin e Punës së Kuvendit të futet edhe parashikimi ose mbajtja e dy vizitave studimore. Tjetër send nuk ka, kush do me e marrë fjalën para se me e hedhë në votim këtë rend të ditës? Fjalën e ka kërkuar zotëri Jetmir Ajdini nga Lëvizja Vetëvendosje.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje për të gjithë! Propozojmë që si pikë e rendit të ditës të futet edhe falja e tatimit në pronë, në vlerë prej 100 euro për vitin 2023 për të gjithë tatimpaguesit e Komunës tonë. Për shkak të inflacionit që e kemi, edhe rritjes së vlerës së tatimit në pronë, propozojmë që kjo vlerë t' u falet të gjithë qytetarëve të Komunës tonë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, Jetmir!, E kemi domethënë edhe propozimin nga grupi i Lëvizjes Vetëvendosje, nga Jetmir Ajdini, për faljen e tatimit në pronë për të gjithë qytetarët të cilët pagujnë në vlerën nën 100 euro. Atëherë e hedhim në votim...po, fjalën e ka kërkuar kryetari.

**Bexhet Xheladini:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, zëvendëskryesues, të nderuar asambleistë, mjete të informimit, përfaqësues i OSBE-së dhe ju të tjerë. Ju përshëndes, ju falënderoj për pjesëmarrjen na takimin e parë të Asamblesë Komunale. Unë vetëm deshta lidhur me propozimin e asambleistit nga radhët e VV-së për faljen e borxhit. Unë e kisha lut, nëse ka mundësi, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, dy minuta ni konsultim në zyrën time me dalë, të mirrna vesh, edhe, para se me e qit në votim. Le të vjen dikush i VV-së, i PDK-së, i LDK-së, edhe

i minoriteteve, dy minuta sqarim, edhe na pastaj mund të vijmë në Asamble edhe të shohim për këtë pikë të rendit të ditës. Për mos me bo debat në tubim, nëse ka mundësi.

**Uran Halimi:** Në rregull. Atëherë propozon kryetari që, në fakt ju fton të gjithë përfaqësuesve të grupeve parlamentare që me organizue ni takim paraprakisht, para se të votohet rendi i ditës. Fjalën e kërkoi zoti Sejdiç dhe pastaj mundeni me shkue...

**Bexhet Xheladini:** Edhe zoti Sejdiç munden me marrë pjesë në takim, nuk është problem.

**Uran Halimi:** Okej, atëherë i kemi 15 minuta pauzë... ni pauzë të pacaktuar derisa sa të kthehen shefat e grupeve parlamentare.

Po vazhdojmë më seancën. Ftoj përfaqësuesin e e takimit, me na dhënë një sqarim se çka u vendos në atë takim. Fjalën po e kërkon Jetmir Ajdini.

**Jetmir Ajdini:** Pas diskutimeve me të gjithë grupet parlamentare të KK – Dragash, erdhëm në përfundim që propozimi im, si dhe propozimi që e ka bo drejtori i Financave, të futen në pikat e rendit të ditës, dhe në momentin që Qeveria ose Kuvendi i Kosovës vendos në favor të Ligjit për faljen e borxheve, atëherë këto pika të rendit të ditës të hyjnë në fuqizim. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Domethënë, me ç'unë e kuptova, i bjen që po tërhiqen të dy propozimet a po? Në rregull, kryetari po na jep edhe ni sqarim.

**Bexhet Xheladini:** Në kuadër të pikës së rendit të ditës, të cilën e ka propozue dje drejtori i Buxhetit dhe Financave, e që e ka miratue Komiteti, në kuadër të kësaj pike diskutohet edhe propozimi i doktorit, edhe të merren do të thotë dy... të jipen dy rekomandime, edhe rekomandimi për shtyrjen e vlerësimit, edhe rekomandimi për faljen e borxhit. Me ni vendim të bien dy rekomandime, edhe faljen e borxhit deri në 100 euro, do të thotë në kuadër të kësaj pike do të diskutohet, do të debatohet, kanë të drejtë delegatët me dalë këtu me debatue, me dhonë forma të ndryshme, mirëpo na u pajtuam që këto dy pika t'i kalojmë.

**Uran Halimi:** Domethënë na po e vazhdojmë seancën me propozimet, a po? Rendi i ditës dhe propozimet. Okej, fjalën po e kërkon zotëri Sejdiç.

**Nedžmidin Sejdiç:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për hir të mirëkuptimit, u dakorduam në takimin e shkurtër që patëm në zyrën e kryetarit që propozimi i z. Ajdini të kalojë unanimisht në kuvend dhe të shqyrtohet bashkërisht këtu dhe të hapim debate këtu. Në atë takim kemi rënë dakord për 2 module, por kjo nuk do të thotë se nuk do t'i prezantojmë këtu në këtë kuvend, sepse mund të ketë propozime të tjera nga delegatët që janë të mira për qytetarët. Ne ramë dakord që të bëjmë ndryshime dhe plotësime në rend dite dhe propozimi i z. Ajdini për faljen e borxhit deri në 100 euro të hyjë në rend dite.

**Uran Halimi:** Faleminderit. Atëherë, nëse dikush tjetër s'ka diçka për me shtue, e hedhim... fjalën e ka kërkue zoti Shpetim Hajredini nga PDK.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë përshëndetje edhe ni herë për të gjithë! Pasi që nuk jena të gjithë në Komitet të Financave, kish qenë mirë që propozimin e drejtorit, me dalë drejtori me e marrë fjalën

dhe me bo pak ni sqarim para të gjithë asambleistëve, me pas pak më të qartë se çka përmban kjo pikë e rendit të ditës, me këtë nen të veçantë. Ju falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit zotëri Hajredini, e ftoj drejtorin për Ekonomi dhe Financa që të na jep ni sqarim në lidhje me propozimin e tij.

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë juve delegatë dhe të pranishëm. Sektori i Tatimit në Pronë, i cili punon në kuadër të Departamentit për Buxhet, Financa dhe Zhvillim, në Drejtoratin për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim të Komunës së Dragashit, i propozon Kuvendit Komunal të Dragashit, gjithashtu i ka propozue dhe KPF-së që të hyjë në rend të ditës propozimi për Ministrinë e Financave, Transfereve dhe Punës, për pezullimin e vlerësimit të pronës për vitin 2023. Pezullimi për vlerësimin e pronës për vitin 2023, për faktin se vlerësimi i pronës që është bo për vitin 2023 ka reflektue në ngritjen e tatimit në pronë. Në qoftë se nuk e bojmë pezullimin dhe nuk biem në vlerësimin e vitit 2022, faturat në mënyrë automatike marrin rritje. Ky Kuvend ka qenë ai Kuvendi i cili ka marrë ni muaj ditë, pa e ditë se do të vijmë në këtë situatë, ka marrë vendim dhe e ka krye obligimin e vet ligjor që i ka takue si Kuvend, dhe e ka ulë normën nga 0.17 % në 0.15%, e që për fat të mirë në komunën tonë ka reflektue me ni rritje ma të vogël. Dhe, si Kuvend Komunal nuk kemi të drejtë që të marrim vendim në raport me qeverinë edhe Kuvendin e Kosovës, prandaj kemi rekomandue që ta pezullojë këtë vlerësim. Po edhe propozimi për faljen në 100 euro mund të shkojë si rekomandim në kuadër të këtij rekomandimi, biseduam, për faktin se të dyjat e plotësojnë njëra-tjetrën dhe shkojnë në favor të qytetarit. Në disa komuna, në qoftë se nuk bohet rivlerësimi i pronës për vitin, nuk pezullohet vlerësimi i pronës për vitin 2023, pavarësisht se iu falen borxhet deri në 100 euro, realisht rritjet janë qaq të mëdhaja, sa që prapë ata kanë rritje. Mirëpo na nuk jemi të obliguet për komunat, për komunën tonë e kemi kështu situatën, dhe këto të dy rekomandimet në qoftë se shkojnë në mënyrë paralele, e polotësojnë njëra-tjetrën dhe nuk e dëmtojnë qytetarin e Komunës së Dragashit. Prandaj, i kemi rekomandue Kuvendit kështu: KK i Dragashit rekomandon, sipas pikës së rendit të ditës, rekomandon Ministrisë së Financave, Transfereve dhe Punës që Vendimi për rivlerësimin e pronave të pezullohet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, në këtë rast të Komunës së Dragashit, të paguajnë vlerën e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023 njëjtë siç kanë paguar në vitin 2022. Siç ka qenë prona domethënë e vlerësuet në vitin 2022. Dhe kjo në mënyrë automatike, në qoftë se kalon ky rekomandimi jonë, qytetarët tonë veç janë të falur. Prandaj, meqenëse nuk kemi të drejtë si Kuvend të marrim vendim, për shkak se vendimi i tatimit në pronë është ekskluziv vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nuk ka të drejtë as ministria dhe as kuvendet komunale. Na mund të flasim për normat, po jo për ligjin. Për këtë arsye gjetëm ni konsensus të përbashkët, me propozimin e delegatit nga VV-ja, që këtij rekomandimi t'i bashkëngjitet edhe rekomandimi nga VV-ja, që në rast se kalon në Kuvendin e Kosovës edhe shlyerja, që të dy këto shlyerjet të reflektojnë dhe na do të jemi të gatshëm si qeveri komunale ta ekzekutojmë vendimin, së paku deri më 31 mars që është e parapame në bazë të ligjit. Unë besoj se është e kjartë kjo dhe asnjë rekomandim nuk i shkon në dëm qytetarit, unë besoj se secili delegate është i interesuet që të shkon në favor të qytetarit dhe ky do të ishte konsensusi ma mi mirë për këtë moment. Falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit, zotëri Kolloni! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës me propozimet e cekura më herët? Po e lypish fjalën a po? Më falni veç ni minutë për Artanin.

**Artan Loshaj:** Kryesues, po due me e pas të kuartit. Përshëndetje për të gjithë! A po hi në rend të ditës vetëm ky propozim, apo të gjithë ato që i thajë ma herët?

**Uran Halimi:** Kanë me hi të gjitha veç e veç, nëse dikush tërhiqet prej propozimit të vet.

**Artan Loshaj:** Okej. Dje në KPF kemi diskutue për Raportin e Punës, edhe ma ceke emrin kryesues, dhe po, është e vërtetë që në raport kam kërkuar unë llogaridhënie dhe kam kërkuar që në Planin e Punës të kemi dy vizita, po kjo ka qenë pak ironike, se më keqkuptove, se kërkesa ime dje nuk e kemi qit në votim për me kaluar si propozim i Kuvendit. Kështu pak më qite në lajthitje ti mu, ta kemi të kuartit, i kemi edhe delegatët që kemi qenë, ka qenë propozim i imi, po nuk e kemi votue, është Arijeta këtu, është Xhemilja, je ti, është kryesuesi, ky zëvendëskryesuesi. Kjo ka qenë pak ironike dje, unë tërhiqem prej kësaj, arsyetimin pse tërhiqem jau jap pasi del në rend të ditës, Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit Artan! Nëse s'ë kemi votue, unë të pyeta, të pyeta, thash e kemi propozimin e Artanit, ti nuk e mohove. Sidoqoftë, e tërheqim propozimin e Artanit. Vazhdojmë me votimin e këtij rendi të ditës, pa propozimin e Artanit. Në rregull, atëherë duhet të hedhim në votim vetëm propozimet që janë bo së pari, e mandej kemi me votue për rendin e ditës, duke përfshirë propozimet. Kush është pro dy pikave, dy propozimeve të cilat janë bo nga drejtori edhe nga grupi parlamentar i LVV-së? Kundër? Abstenim? Atëherë konstatoj se me 26 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim, kalojnë të dy propozimet e bëra më herët. Vazhdojmë me votimin e rendit të ditës, duke përfshirë edhe propozimet. Kush është pro këtij rendi të ditës, i cili përmban edhe propozimet e lartcekura? Kundër a ka? Konstatoj që me 26 vota pro, me 0 kundër dhe 0 abstenim, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, është miratimi i procesverbalit nga seanca e XII për vitin 2022. Nëse do dikush me marrë fjalën në lidhje me procesverbalet e seancës së kaluar. Nëse jo, e hedhim në votim, kush është pro pikës së parë të rendit të ditës? Kundër a ka? Abstenim a ka? Me 26 vota pro, zero kundër dhe 0 abstenim, kalon miratimi i procesverbalit të seancës XII. Te pika e dytë e kemi Raportin e Punës së Kuvendit për vitin 2022 dhe Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2023. Atëherë unë këtu e kam ni raport të cilin jau kemi dërgue edhe juve, po e lexoj në pika të shkurta Raportin, edhe pastaj kemi mundësi ta diskutojmë... Nëse dikush do me marrë fjalën, edhe me dhonë ndonjë sugjerim, vërejtje, apo diçka që kemi bo lëshime, mundim me diskutue. Fjalën e ka kërkuar zoti Loshaj.

**Artan Loshaj:** Kryesues, tash kam me ta plotësue dëshirën për këtë pikë të rendit të ditës. Dje në Komitet e kemi diskutue, po prapë unë sot këtu do t'i jap disa vërejtje dhe disa sugjerime, ku në fund, për mos me ju ndalë shumë, në fund si përfundim Raporti i Kuvendit të KK-Drashës është dëshmi e respektimit të dispozitave ligjore, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performancës sa ma të mirë. Ky raport për mu është ni raport shumë i shkurtër, me siguri ke desht mos ma na mundue shumë me lexue, po unë e kom ni kërkesë: shkaki i llogaridhënies dhe transparencës, që të jetë publike këtu për të gjithë qytetarët por edhe delegatët të cilët nuk kanë qenë, vizita studimore në Kroaci, tenderi sa ka qenë, qysh ka qenë tenderi, në atë hotel që kemi qenë sa yje ka pas me qenë edhe në sa yje na keni çue. Unë si delegat, si përfaqësues i gjithë qytetarëve të Drashës, atë kërkesën, kryesues kam qef me më ngue qetash, atë kërkesën që e kam bo për në Plan të Punës, për... unë kam qef që në raport të jetë aty, thashë edhe ni herë, sa pare ka qenë tenderi, kush e ka fitue atë tender, sa yje ka qenë hoteli, në sa yje na keni çue, vetë e dini

shumë mirë që ni zyrtar i juaji këtu ka qenë i pakënaqur, dhe jemi të gjithë dëshmitarë këtu, na ka nalë edhe autobusin në gjys të rrugës, ka thonë që diçka s'është i kënaqët me ni vizitë studimore, dhe ka lyp që në vitin 2023 të kemi dy vizita studimore. E unë për hir të kërkesave të juaja, unë i përfaqësoj të gjithë qytetarët, edhe kam kërkuar që në Planin e Punës 2023 të jenë dy vizita studimore, jo që unë kam kërkuar, po u konë kërkesë e punëtorëve të juaj, punëtorit të Kuvendit, edhe kam pas qef me ia plotësue dëshirën. Kërkoj edhe ni herë, për hir të qytetarëve dhe për hir të transparencës, që të jetë publike tenderi i Dubrovnikut, edhe të jetë në faqen zyrtare të Komunës së Dragashit. Faleminderit.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Loshaj! Fjalën e ka kërkuar zoti Nedžmidin Sejdlar.

**Nedžmidin Sejdlar:** Të nderuar të pranishëm, z. Kryesues, më duhet të pranoj se plani juaj është më i mirë se raportit. Meqë këtu e kemi në letër, e vetmja gjë me vlerë është fotoja në faqen e parë. Teksti i cili është shumë i pakët duket më shumë si një udhëzim se si bëhet një raport dhe mendoj se është turp të publikohet një raport i tillë në faqen e komunës, sepse kushdo që e shkarkon këtë raport nga interneti do të qeshet me neve. Që në fillim të raportit thuhet se kemi pasur 10 seanca të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, ku kemi diskutuar 74 pika të rendit të ditës. Ne patëm më shumë se 60 orë diskutim në këtë asamble dhe imagjinoni nëse vendosni 60 orë diskutim në dy faqe të shtypura si orar klase me pushime në bllok. Këtu kemi shumë pedagogë dhe nëse një nxënës do të shkruante një dokument të tillë, nuk do të kalonte as klasën e parë. Nuk e di kush e ka shkruar këtë raport për ju, mos u ofendoni, ndoshta nuk jeni ju, ndoshta keni gjetur një lloj draft dokumenti dhe mendoj se të paktën duhet të kishit kërkuar ndihmë nga këshilltarët tuaj ose nga ne për të përgatitur një raport cilësor, sepse ky raport nuk është vetëm pasqyra juaj, por edhe pasqyra e gjithë Kuvendit, anëtar i të cilit jam edhe unë. Kuvendi ka buxhetin e vet. Së paku, duhet të kishit përfshirë një tabelë në këtë raport për të treguar se ku i kemi shpenzuar gjithë ato para. Këtë kanë të drejtë ta dinë qytetarët e kësaj komune, sepse ndër të tjera financohemi direkt nga xhepat e tyre. Në lidhje me vizitën studimore z.Loshaj e ngriti çështjen, ka absolutisht të drejtë, po ashtu qytetarët e kësaj komune duhet ta dinë që ne shkojmë në vizita studimore që nuk janë të paligjshme, nuk po bëjmë asgjë të keqe, por në ato vizita studimore unë do t'ju kërkoj që herën tjetër që të hapni tender, të vendosni një klauzolë prej 20% për koordinatorin. Të gjithë ju këtu jeni dëshmitarë të asaj që ndodhi në autobus. Vetë njeriu e pranoi, nuk i grisja fjalët, ai vetë tha që nuk më mjafton një vizitë studimore me 20% të parave, i duhen të paktën 2 vizita studimore në vit. Pra, ne duhet të vendosim atë 20% dhe ta taksojmë atë 20% të parave të fituara. Ju flisni edhe për punën e komitete te kuvendit, në të cilin tregoni se sa pika të rendit të ditës i kemi shqyrtuar dhe nuk keni mundur të përfshini në këtë raport disa nga vendimet që i kemi marrë unanimisht. Sepse nëse një i huaj e lexon këtë raport, nuk do ta dijë se çfarë kemi vendosur ne, qytetarët nuk e kanë idenë se çfarë kemi vendosur. Ju së paku mund të kishit përmendur vendimin që kemi marrë unanimisht për ndërtimin e stadiumit në fshatin Blaç sipas procedurës emergjente, mendoj se stadiumi ka përfunduar, sepse procedura emergjente nga marsi në mars duhet të përfundojë deri më tani. Prisja që pushteti komunal të më ftonte në hapjen e atij stadiumi. Ju shkruani këtu se ai komitete ka pasur 11 mbledhje dhe ka shqyrtuar kërkesat e komuniteteve. Unë jam anëtar i të njëjtit komision dhe mund të them me siguri se ai komitet është tërësisht jofunksional. Asnjë kërkesë e vetme nuk u shqyrtua në atë komitet. Ju lutemi mos e shkruani këtë, sepse nuk kemi marrë asnjë kërkesë. Ja ku është Rahta, le të ngrihet dhe të thotë çfarë kërkesë kemi marrë. Ka kërkesa që i janë drejtuar komitet për komunitete, por ju me mashtime te juaja nuk keni sjellë asnjë kërkesë që i është drejtuar atij komiteti. Madje ju keni kërkuar pengesa procedurale, gjoja numri i protokollit në

kërkesë nuk përputhet me komitet për komunitete. Secila prej këtyre kërkesave ka titullin K. për Komunitetet. Së treti, pse ai komision nuk është funksional, është se presidenti nuk na kushton vëmendje. Që nga dita kur ka emruar nënkryetarin për komunitete, nuk e kemi parë në K. për Komunitete. Një herë ishte 2 minuta dhe kjo ishte e gjitha në një vit. Mendoj se është turp të publikohet ky raport në uebsajt, të krijohet një grup pune që do të bëjë një raport më të mirë për ju. Sipas këtij Plani, shoh që do të kemi edhe dy seanca deri në fund të muajit, nuk e di si do t'ia dilni. Jam dakord që duhet të përfshijmë një vizitë studimore në këtë Plan, duhet të planifikojmë atë, cilat qytete do të vizitojmë, me cilat Kuvende do të shoqërohemi dhe do të shkëmbejmë përvoja. Kjo nuk ka të bëjë me ju, ky raport duhet të mbrojë reputacionin tonë, dhe siç është, nuk mund të lejoj që një raport si ky të jetë në faqen e internetit pa thënë asgjë për të. Në thelb, ky raport nuk ka asgjë në të.

**Uran Halimi:** Faleminderit i nderuar! Po flasim për vizitën studimore, e cila është bo hit, e kemi të postume në uebfaqe, shpenzimet edhe agjendën, në faqe të Zyrës së Prokurimit. Sa i përket gjërave të tjera, janë diskutime shumica të pabaza, u ndalem ma së shumti te Komitetet, se qytetarët s'i kanë përcjellë ato direkt. Sa i përket punës së Kuvendit, qytetarët e dinë çka kemi bo, se ata na ndjekin. Kemi organe mbikëqyrëse edhe të Komiteteve, edhe të seancave. Jolegjitim për me e shpallë ni Komitet, duhet me pas kompetenca për me i mbikëqyrë ato për m'i shpallë jolegjitim. Unë për vete s'mundem me shpallë jolegjitim diçka që s'jam adekuat, për qato konteksti i diskutimeve shpeshherë po devijon, edhe s'e di sa ia vlen me diskutue për diçka që s'jemi adekuatë. Unë për vete zakonisht flas për tema të cilat kam njohuri edhe i argumentoj. Sidoqoftë, vazhdojmë me rendin e ditës, kush është pro këtij Plani të Punës për vitin 2023? Kush është kundër? Abstenim? Konstatoj që me 18 vota pro, me 1 kundër edhe 6 abstenim, kalon pika e dytë, është fjala për pikën e Raportin e Punës së Kuvendit. Te pika e tretë e kemi propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për Komunën e Skënderajt. Ftoj kryetarin që ta marrë fjalën në lidhje me këtë pikë.

### Pika III

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar delegatë, ju e dini që në katër komuna të Kosovës kanë ndodhë vërshime, e njëra prej komunave më të prekura ka qenë Komuna e Skënderajt. Qeveria Komonale ka mbajtur takim, edhe njëra prej konkluzioneve ka qenë edhe që Asambleja Komonale e Dragashit të debatohet në njërin prej seancave, edhe të merre ni vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 10 mijë euro nga pozicioni subvencione dhe transfere, nga zyra e kryetarit. Për këtë qëllim, ne ni delegacion i përbërë prej partive politike, kemi qenë në Komunën e Skënderajt, i kemi bon i vizitë kryetarin, edhe kryetari na ka prit jashtëzakonisht mirë, edhe na ka falënderue edhe në takim, po edhe në rrjetet sociale, ju sigurisht e keni lexue falënderimin e tij. Andaj, edhe propozoj që ky Kuvend, jo propozoj por mendoj, që Kuvendi do ta merre ni vendim unanim për ndarjen e këtyre mjeteve. Edhe pse këto janë pak mjete, të pamjaftueshme, po megjithatë është ni shprehje e solidaritetit të Komunës sonë, edhe pse komunë e vogël dhe e varfër, por e kemi zemrën e madhe dhe të gjerë. Kështu që, propozoj që kjo pikë të miratohet. Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** Përshëndetje të gjithëve, më vjen keq për atë që ndodhi në komunën e Skënderajt dhe solidarizohem me të gjithë ata njerëz. Në vitin 2012 kemi pasur një situatë të ngjashme kur kemi pasur një fatkeqësi natyrore me ortekë, gjatë së cilës i gjithë vendi është ngritur në këmbë për të na ndihmuar dhe për të na dhënë çdo ndihmë. Pajtohem me presidentin se jemi një nga komunat më të varfra në Kosovë dhe se kemi zemër të madhe, por edhe kështu mendoj se

10 mijë euro janë shumë pak. Unë e mbështes propozimin e z Kryetarit dhe i propozoj kuvendit që të votohet që qytetit të Drenicës dhe rrethit t'i jepen së paku 50.000 euro, në mënyrë që këto para të mund të përdoren dhe të paktën disa nga shtëpitë e tyre të mund të riparohen. Unë i kërkoj zotit kryetar, nëse pozicita nuk e tërheq propozimin prej 10 mijë eurosh, ta shtini ne votim edhe këtë propozim prej 50 mijë eurosh.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Edhe unë si të gjithë të tjerët pajtohna plotësisht për ndarjen e mjeteve për ndihmë në zonat e prekura në Komunën e Skënderajt. Po ashtu, edhe kërkoj nga pushteti qendror, për këtë desha të flas, qeveria qendrore të ndryshojë disa çështje lidhur me fatkeqësitë elementare. Pra unë po kërkoj nga këtu, e ndoshta edhe kryetari dhe organet relevante do të kërkojnë në qendër, që të krijohet ni kod i veçantë në lidhje me këtë drejtim, dhe mjetet të destinohen nëpër komuna, pasi që është një fond rreth 13 milionë euro i cili gjendet në qeveri, por ato mjete rrinë në qeveri. Ato duhet të destinohen me kod të veçantë nëpër komuna dhe komunat t'i kenë në mjete të vetat, dhe në qoftë se nuk ka nevojë, ato mjete prapë kthehen domethënë në qeveri. Dhe po kërkoj nga qeveria qendrore që t'u japë kompetenca komunave, e jo të jau merr, domethënë si po ndodh tani. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** Përshëndetje, i nderuar kryetar, të nderuar kolegë asambleistë dhe ju qytetarë të Dragashit. Ajo që ka ndodhur në Skënderaj dhe disa komuna tjera të Kosovës dhe në shumë vende të botës po ndodh çdo ditë, prandaj është vullneti i Allahut dhe nuk ka kush që i del para. Ajo që është e jona dhe që na takon neve të bëjmë, në bazë të mundësive tona financiare, po e shofim që edhe ekzekutivi e ka marrë vetëm ni vendim të tillë, sado që shuma ne e konsiderojmë si të vogël, është, besoj tregon solidaritetin që ne t'i gjendemi pranë së paku këtij qyteti, i cili është prekur pak më tepër në krahasim me qytetet e tjera, edhe pse unë po besoj që është shumë shumë e vogël dhe kish qenë mirë që, në bazë të mundësive financiare, së paku të shtohen bile edhe 5 mijë euro, por këtë besoj që e ka vlerësuar drejtori i Financave dhe mundësitë nuk besoj që i ka pas që të ndahen do të thotë edhe 5 mijë. Përndryshe do ta kishte bërë ni ndarje të tillë. Në të kundërtën, unë kërkoj që nëse është mundësia që së paku edhe 5 mijë apo 7 mijë të ndahen dhe të jepen edhe për komunat tjera, apo të dedikohen shuma komplet, 15 mijë apo 17 mijë, vetëm për Skënderajn. Sido që të jetë, ndodh rritja apo nuk ndodh rritja, ne si grup i Partisë Demokratike do ta mbështesim këtë vendim, i cili është për të mirën, sado pak që do ndikojë, të familjeve të prekura nga vërshimet të cilat kanë kaplue qytete të ndryshme të Kosovës. Ju falemnderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, zotëri Hajredini! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkuar zoti Munir Jonuzi nga Partia VAKAT.

**Munir Jonuzi:** Përshëndetje të gjithëve, këtë prezantim do ta filloj me një fjali që tha Kryetari ynë, gjegjësisht tha se jemi komunë e vogël dhe e varfër, por jemi komunë me zemër të madhe. Ashtu është, qytetarët tanë kanë vërtet një zemër të madhe, kushdo që ka nevojë, qytetarët tanë janë ndër të parët që përgjigjen. Ata i ndajnë mjete te tyre për të na ndihmuar të gjithëve. Nëse është e nevojshme të hapen puse në Afrikë, nëse Jemeni dhe Siria kanë nevojë për ushqim, nëse nevojiten ndihma humanitare për të ndërtuar shtëpi, nëse nevojitet ndihmë për të sëmurët, qytetarët tanë janë të parët që përgjigjen dhe të parët që ndihmojnë. E njëjta situatë vlen edhe për vërshimet që goditën komunën e Skënderajt. Organizata joqeveritare Beriqtet pranë Bashkësisë Islame ishte e para që iu përgjigj thirrjes dhe dërgoi pako ndihma në komunën e Skënderajt. Komuna jonë nuk mbetet prapa në këto veprime, andaj Kryetari i komunës me delegacionin e tij ishte ndër të parët

që shkoi dhe vizitoi komunën e Skenderajt. Megjithatë, këtu, si përfaqësues të popullit, duhet të tërheqim vëmendjen për disa fakte. Natyrisht, ne kemi empati me qytetarët e komunës së Skenderajt. Sepse në të kaluarën jo shumë të largët, ne vetë ishim viktimë të fatkeqësive natyrore. Në vitin 2020, komuna jonë u godit nga një përmbytjet. Kemi pasur dëme të mëdha materiale, a mund ta imagjinoni sa komuna na kanë ndihmuar, as një, sa mendoni se na ka ndihmuar qeveria në riparimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, asnjë cent, në fakt na ka ndihmuar qeveria duke na lejuar të ndryshohen kodet buxhetore për burime të caktuara financiare dhe le t'i ridrejtojmë për rehabilitimin e dëmeve materiale të shkaktuara nga përmbytjet. Në mbledhjen e kuvendit kemi ndarë 120 mijë euro për riparimin e dëmeve, është formuar një komision që i ka shpërndarë ato para. Falë Zotit që nuk ka pasur viktimë njerëzore në vërshimet që ka përfshirë komunën tone si dhe komunën e Skenderajt. Fatkeqësisht nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ortekun në Restelicë. Fatkeqësisht, atëherë humbëm 11 persona. Vetëm një vajzë mbijetoi. Asokohe Restelica ishte qendra e Kosovës, atëherë të gjithë ndihmonin, edhe policia edhe ushtria e Kosovës, politikanë të ndryshëm, ishte vetë kryeministri, presidentja e Kosovës në atë kohë, të gjithë gazetarët ishin aty dhe të gjithë donin të ndihmojnë në një farë mënyre. Të gjithë premtuan ndihmë të madhe materiale, megjithatë, çfarë ndodhi, ushtria mbaroi punën e saj, po ashtu policia, politikanët u larguan, kamerat u fikën, gazetarët ndoqën ngjarje të tjera. A e dini sa komuna na ndihmuar në atë kohë në vitin 2012, e përsëris edhe një here, as një. Sa mendoni se ka ndarë qeveria për riparimin e dëmeve materiale, asgjë. Dhe kjo nuk është më e keqja, sa para mendoni se ka ndarë komuna e Dragashit, asgjë, ky kuvend që ne përfaqësojmë nuk ka ndarë asnjë cent për riparimin e dëmeve. Më pas kemi formuar një komision dhe komisioni ka konstatuar se dëmi është mbi 500 mijë euro. Ne nuk kemi lënë mënjanë asnjë cent dhe kjo do të mbetet në histori si një pike e zezë e këtij kuvendi. Sigurisht që ne nuk do të jemi si komunat e tjera. Ne kemi ndarë mjete për komunën e Skenderajt. Megjithatë, duhet të jemi të ftohtë, duhet të jemi realistë, duhet të jemi racional dhe të kujdesemi në radhë të parë për qytetarët tanë. Ne marrim kërkesa gjatë gjithë kohës në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe ndoshta është një situatë e ngjashme me Komitetin për Komunitete. Ne duhet të lëmë mënjanë fonde të caktuara në mënyrë që ata të mund të ndihmojnë qytetarët tanë. Prandaj, edhe pse e kemi zemrën e madhe, nuk kemi nevojë të nxitojmë në deklaratat tona. Pra propozimi prej 10 mijë euro për mendimin tim është real dhe racional dhe do ta mbështes si të tillë.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zotëri Jonuzi! E ceku që qeveria s'na ka ndihmue, pastaj ratë ndesh me fjalët tuaja, kur thatë që na ka ndihmue ushtria e Kosovës, policia e Kosovës. Nuk mundën qeveria me e injorue ni zonë, siç ka qenë atëherë vërshimi ose orteku i borës në Restelicë. Sidoqoftë, e lus Zotin që mos të bohemi nevojë për me na ndihmue dikush, e mos të kemi raste të tilla. Ni minutë replikë e ka kërkue zoti Sejdilar dhe pastaj vazhdojmë.

**Nedžmidin Sejdilar:** Fakti që askush nuk na ndihmoi kur ishim në vështirësi nuk do të thotë se nuk duhet të jemi njerëzorë. Ne duhet të sillemi në atë mënyrë që ata që kanë mundur të na ndihmojnë por nuk na kanë ndihmuar, që te turpërohen ata vete, e ne që jemi komunë kaq e vogël, e varfër, por kemi zemër të madhe dhe do të ndihmojmë si duhet në Drenicë. . Shpresoj që të gjithë ju këtu në këtë kuvend të votoni për t'i ndihmuar me 50 mijë euro. Zoti Jonuzi, edhe ju thatë se ky kuvend nuk ka marrë vendim për t'i ndihmuar qytetarët kur ndodhi orteku në fshatin Rastelicë në vitin 2012, më duhet t'ju kujtoj se ju si subjekt politik keni qenë pjesë e këtij kuvendi. dhe se as atëherë nuk e ngritët këtë çështje. Më vjen keq që duhet t'ju kujtoj fakte të tilla, por ju keni qenë pjesë e këtij kuvendi dhe pse nuk e keni bërë atëherë. Pse keni pritur deri tani? Dhe fakti që askush nuk donte të jepte asnjë cent është punë e tyre. Ne duhet të tregojmë me shembullin tonë se jemi

solidarë në kuptimin e vërtetë, ndër të tjera, komuna ka para, qeveria mburret çdo ditë se buxheti po rritet gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës. Ne mund të ndajmë 50 mijë euro për ata që janë prekur nga përmbytjet për të rregulluar ndonjë problem dhe ja ku mund t'i kursejmë ato para. Ja një shembull i thjeshtë: kryetari i komunës le t'ia heq makinën shefit të zyrës për komunitete. Ai shpenzon 5 deri në 6000 euro në vit për karburant për asgjë. Hiqni automjetin e tij, taksoni ata që fitojnë 20% nga projektet, do të mbledhen 50 mijë euro. Paratë janë të mjaftueshme, pyetja është nëse kemi vullnet për të dhënë kaq shumë para, për të bërë diçka konkrete, apo do të blejmë simbolikisht marketingun me 10 mijë euro.

**Munir Jonuzi:** Sa për faktin që e rash ne ndesh me vete veten, nuk është e vërtetë, fola për ushtrinë dhe policinë, thashë që qeveria nuk dha asnjë cent. Po mendoja për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga orteku, ndërsa për kolegun tim Nedzmidin, përfaqësoj subjektet politike të Koalicionit Vakati, i cili disa herë ka paraqitur propozime për riparimin e dëmeve në mandate deri në vitin 2013, pastaj nga viti 2013 në 2017, pastaj deri në vitin 2021. Kolegut tim të koalicionit Vakati e theksuan këtë çështje pa ndërprerje. Pra, nuk është se nuk kemi dashur të ndihmojmë dhe nuk e kemi theksuar këtë çështje, e kemi theksuar, por nuk kemi arritur t'i ndajmë ato mjete.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Jonuzi! Unë të kam keqkuptue, mendova që është fjala për ndihmën në përgjithësi, konga konë të ndihma financiare, atë s'e dita unë. Sa i përket kuvendeve të mahershme, keni mund me ndihmue edhe ju, jeni konë pjesë e atyre kuvendeve, qetash jemi na në Kuvend edhe, nëse kemi dëshirë me ndihmue ndihmojmë, nëse jo, prapë është në ndërgjegjen tonë. Thash edhe ni herë, ishalla s'na bon Zoti me na ndihmue dikush, ishalla jemi mirë edhe rahat, po s'dihet. Vazhdojmë më tutje, dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë e kemi propozimin e zotit Nedzmidin Sejdar...veç pak delegatë, kur bohet propozimi, sefte hudhet propozimi në votim, a kalon a s'kalon, pikën e kryetarit na e kemi... jo a. Veç pak, para se me kalue te votimi, fjalën e ka kërkue drejtori për Ekonomi, ta shohim çka po na thotë ky, a ka mjete a qysh është gjendja.

**Qamil Kolloni:** Ju përshëndes të gjithëve! Në fillim kur ka ndodh kjo ngjarje, kryetari në mënyrë automatike e ka thirrë Qeverinë Lokale. Përpos që e ka thirrë Qeverinë Lokale edhe i kemi marrë qëndrimet për ndarjen e mjeteve, ne në radhë të parë e kemi shique buxhetin. Ju e dini që qe ky Kuvend, edhe rasti ka ndodh masi është miratue buxheti i Komunës së Dragashit, dhe mjetet të cilat i kemi pas të gjitha në dispozicion i kemi analizue se çka mundim të bojmë. Unë e çmoj shumë vullnetin e juaj që na të ndihmojmë sa ma shumë, nuk ka kurgjo të keqe këtu. Mirëpo, na mund të ndihmojmë në aspektin çka mund të japim. Na mund tash edhe ta votojmë, po s'kemi mjete të lira që mund të bojmë, për arsye se ky Kuvend ka marrë ni vendim për ndarjet buxhetore paraprakisht. Dhe na ato i kemi nda deri në cent, nuk kemi pas lluft, se nuk kemi parapa që do të na ndodhë kjo situatë. Prandaj e kemi këqyr cili pozicion mund të shfrytëzohet për këtë rast. Përpos kësaj, kryetari ka thirrë edhe bizneset lokale, që në mënyrë interne, të ndihmojnë në atë qytet. Përpos kësaj, ka angazhue edhe organizatat humanitare, Kryqin e Kuq edhe bashkësitë islame, të cilat funksionojnë kësaj komune. Domethënë, është mundue që përpos kësaj shumë financiare, të çojmë edhe ndihmat tjera. Disa ndihma kanë shkue edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe unë mendoj se qytetarët e Komunës së Dragashit, njëkohësisht edhe ju si përfaqësues, e keni dhonë...dhe mendoj se me edhe me këto 10 mijë euro, me ni vendim shumë racional që nuk do të ketë implikime buxhetore, do ta kishna plotësue edhe atë pjesën dhe unë menoj se do të ishim në rregull edhe si qytetarë, edhe jus i delegatë, po edhe propozimi i kryetarit edhe krejt ai angazhim që është bo,

mendoj se do të reflektojë pozitivisht. Prandaj ju lus që, pa e politizue, pa u mundue me sjellë emocione, me qenë shumë realë edhe konkretë. Këto janë mjetet të cilat kemi për momentin në dispozicion, t'i votojmë, dhashtë Zoti ishalla na vijnë pare të tjera ma tepër edhe mund të ndihmojmë ma tepër. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Kolloni! Realisht, i bjer që nëse s'ka qaq mjete, është propozimi pa bazë, sikur unë mos me e ditë sa pare kam në xhep, e me të thonë t'i jap ma shumë se që kam. Sidoqoftë...e ke bo replikën. Hajt ni minutë. Sidoqoftë, e hedhim në votim propozimin e zotit Sejdlar. Kush është pro që Komuna jonë në vend se të ndihmojmë me 10 mijë euro, të ndihmojmë me 50 mijë euro? Kush është pro propozimit të zotit Nedžmidin Sejdlar që t'i dhurojmë Komunës së Skënderajt 50 mijë euro? Kush është kundër? Veç pak, mos u mundohnu me bo kryesuesin, se unë jam këtu për këtë punë. Nëse unë gaboj, unë tërhiqem, kërkoj falje, unë mbikëqyrem për gabimet, jap llogari për gabimet e mia, qetash çka me votue, çka mos me votue, unë bre e di. I nderuar Xheladini, duhet me u kundërshtue, nuk kaloi, dikush voton kundër. Okej, nuk kalon propozimi i zotit Sejdlar. Kush është kundër propozimit të zotit Sejdlar, kush është kundër këtij propozimi? Po në rregull, abstenim? Ni minutë e ka lyp Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë unë në fjalimin tim u mundova të jam shumë profesional edhe shumë i kulturuar, pasi kërkova shpjegim nga drejtori i Financave që a janë mundësitë me u shtue, dhe ishte një shumë e vogël 5 mijë deri në 7 mijë euro, mirëpo së pari kërkova të jetë sqarimi që janë mundësitë e bartjes së 7 mijë eurove nga ky pozicion i subvencioneve apo jo. Në momentin që drejtori e dha përgjigjen e tij që mundësitë nuk janë të tilla, atëherë edhe unë s'kam çka kërkoj dhe e rëndoq më shumë buxhetin e Komunës, kur mundësitë nuk janë. Atëherë e tërhek unë këtë propozim timin dhe vazhdojmë me propozimin e mahershëm, me propozimin e kryetarit.

**Uran Halimi:** Qetash edhe ni herë ju lutem qetësi, kështu merrne ma qetësi edhe ma larg zemrës. Na duhet çdo propozim me e hedhë në votim, me e krye atë propozimin, pro ose kundër, m'u krye ajo çështje, që na mos me lonë hapësira, u votue s'u votue, a po më kuptoni. Unë e qes në votim, ju jeni ata që e vendosni pro-kundër. Mos e merrni shumë personale edhe shumë ngat zemrës. Qetash duhet me mbyllë si procedurë propozimin e zotit Sejdlar. Kush është pro propozimit të Nedžmidin Sejdlar që Komunës së Skënderajt t'i ndahen 50 mijë euro? 1 votë pro. Kush është kundër? Nuk ka kundër, kush është abstenim? Të nderuar, konstatoj që propozimi i zotit Sejdlar nuk kalon. Vazhdojmë me votimin e propozimit të cilin ju veç e keni në material, domethënë duhet të votoni për propozimin e bërë nga kryetari dhe unë, që Komunës së Skënderajt t'i ndajmë 10 mijë euro vlerë mjete financiare. Kush është pro këtij vendimi? Kush është kundër këtij vendimi? Abstenim? Konstatoj që me 25 vota pro, me 0 kundër edhe 1 abstenim, kalon propozimi për ndihmesën e Komunës së Skënderajt, në vlerë prej 10 mijë euro. Faleminderit për unitetin! Nëse mendoni që me pas ni pauzë është mirë...ka pika edhe të tjera, se janë edhe propozimet e mahershme. Atëherë po marrim nja gjys ore pauzë edhe kthehemi në seancë në ora 12:30. Ju lutem, në ora 12:30 fiks e vazhdojmë seancën...

#### Pika IV

...E kemi vazhdimin e seancës me pikën e katërt, është Rishqyrtimi i Vendimit për ndryshimin e qëllimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, e kisha lut kryetarin e Komunës të na japë ni sqarim në lidhje me këtë pikë. Okej, atëherë e kanë përfaqësuesin e grupit parlamentar të LDK-së. Urdhno, zotëri Myrtezani.

**Naser Myrtezani:** Falemnderit! I nderuar kryetar i Komunës, të nderuar kolege dhe kolegë delegatë, në emër të grupit të asambleistëve të pozitës, propozojmë që Vendimi të rikonfirmohet, për arsye se Vendimi i kaluar nuk ka qenë i kompletuar me dokumentacione. Pasi që tani e kemi edhe konfirmimin e Drejtorisë së Urbanizmit, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. Andaj propozojmë që të votojmë këtë pikë të rendit të ditës. Falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit, zotëri Myrtezani! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkuar zotëri Jetmir Ajdini nga LVV dhe pas tij zoti Nedžmidin Sejdilar nga PZG.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje edhe ni herë! Zotëri Myrtezani, a ka mundësi edhe ni herë ma në detaje me na i shpjegue qeto plotësimet që i kërkoje, vendimin e Gjykatës së Apelit, krejt qeto që i përmende, me na i shpjegue detajisht çka përfshijnë. Falemnderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** Mendoj se këtë temë e kemi diskutuar më 15 dhjetor të vitit të kaluar. Më pas na erdhi një dokument, një lloj vendimi gjyqësor, të cilin e kundërshtova sepse nuk ishte përkthyer siç duhet. Kur kritikova kolegët e mi nga Gora që nuk e dinë gjuhën shqipe dhe kur i pyeta nëse e kuptonin vendimin. Tani e shoh që ministria e ka kthyer këtë vendim. Këtu ne kemi marrë vetëm një hartë nga ju në materialin plotësues dhe nuk na keni dhënë as shpjegim e as vendim të Ministrisë së Administratës dhe Vetëqeverisjes Lokale. Pse po na e kthejnë për rikonfirmim. Që në fillim dua të them se nuk jam kundër ndihmës së investitorit tonë, do ta mbështes nëse është për të mirën e qytetarëve, por dua të di në detaje se çfarë po ndodh këtu. Në praktikë me ju, gjithmonë vendosni një mace në çantë. Nuk na jepni kurrë të gjithë dokumentacionin, gjithmonë lini diçka, na e jepni para seancës në gjysmë ore e 15 minuta, pas seancës. Lidhur me këtë sugjeroj që kjo pikë të shtyhet për në seancën e ardhshme dhe që deri atëherë të na jepni të gjithë materialin e nevojshëm. Nuk e dimë se çfarë vendosi gjykata. Theksoj se nuk jam kundër investitorëve, madje do ta votoj dhe do ta mbështes propozimin e tij, por dua të di saktësisht dhe saktë se çfarë po bëhet.

Uran Halimi: Falemnderit, zoti Sejdilar! Dikush tjetër nëse do me marrë fjalën. Fjalën e ka kërkuar zoti Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë përshëndetje edhe ni herë për të gjithë! Sot në një ndër pikat e rendit të ditës po diskutojmë prapë për Vendimin të cilin e kemi diskutuar në njërin ndër seancat e vitit kaluar, mos gabofsha e parafundit ka qenë, dhe po shihet që ai Vendim është kthyer mbrapsht nga ana e ministrive përkatëse apo nga ana e MAPL-së, në bazë atyre që dëgjova. Por në këtë Vendim nuk e kemi pasur dhe nuk e dimë pse është kthyer prapë dhe çfarë ndryshimi keni tani nga Vendimi i parë. A është e mundur që, edhe sot nëse ne e votojmë këtë propozim, të na kthehet mbrapsht prapë. Do të thotë, atë që e ka kërkuar Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal a është ndryshuar dhe a është përmirësuar apo jo. Mirëpo, sido që të jetë kjo ju takon juve prapë, ne si grup nuk po jap fjalë që do ta mbështesim, megjithëse unë personalisht jam pro këtij propozimi, pasi që nuk mund të jam kundër bizneseve dhe kundër atyre që planifikojnë që në të ardhmen të hapin vende të reja të punës, dhe anën ligjore po ia lejojmë që ta kryje prapë Ministria dhe përgjegjësinë ta bart mbi vete ekzekutivi. Po shpresoj që këtë radhë nuk do të na kthehet prapë, dhe ky propozim të merr finalizimin e duhur dhe ky person në fjalë të fillojë punën, Zoti i ndihmoftë ishalla.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Hajredini! Fjalën e ka kërkuar zotëri Nexhat Selaj nga PDK.

**Nexhat Selaj:** Falemnderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, kolegë, media! Lidhur me pikën e katërt, jam shumë i sigurt se në seancën e dhjetë po më duket, nëse nuk gaboj, njëmbëdhjetë a, arsyeja që e larguat edhe pikën eventuale ka qenë kjo pikë, që me ni formë na kushtëzuar me e lëshuar edhe seancën. Në atë seancë ju keni votuar pro këtij Vendimit. Unë edhe në atë kohë, por edhe tash – kur them ju, është në pyetje për shumicën, nuk është në pyetje për pakicën – unë edhe në atë kohë, po të kisha qenë, por edhe tash, gjithmonë jam në mbrojtje të biznesit. Pasi që lejen për ndërtimin e këtij objektit nuk i keni dhënë leje, as që na është qit në propozim që ne të miratojmë këtë leje, për atë arsye barra kryesore bjer mbi qeverisjen. Por, sa i përket tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ne dimë aty se kemi mbi 30 objekte të ndërtuara. Asnjëri nga objektet nuk ka leje ndërtimi. Unë bash për keqardhje shof se si tentojmë të pengojmë biznesin, i cili të paktën po kërkon leje për ndërtim. Edhe mendimi jem personal është që çdokush që lyp leje, sidomos për bizneset, t'i lejohej, jo vetëm këtij investitori, por të gjithëve. Nisem nga parimi se biznesi në fjalë sigurisht do të punësojë edhe tre apo katër, mos të thom edhe dhjetë punëtorë të tjerë. Ne duhet të jemi ata të cilët u japim prioritet bizneseve, e jo t'i pengojmë bizneset. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Selaj! Meqë jemi pro bizneseve, edhe kemi diskutuar, kemi shterruar çdo debat edhe në seancën e XI qysh e thatë edhe ju. Arsyeja e largimit ose e lëshimit të seancës unë e kam ditë që është kjo. Mirëpo, karremi u konë pika eventuale. Sidoqoftë, po vazhdojmë me votimin. Meqenëse e ka prurë në rishqyrtim kryetari, po besoj që i ka plotësuar kushtet e rishqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, edhe i mbetet Ministrisë me e bo punën e vet në lidhje me këtë, na p'e marrim ni vendim. Nëse nuk është i duhuri, na kthehet prapë, a po kupton, ka ardhë në rishqyrtim, prapë po e bojmë rishqyrtimin. Dua të theksoj që LVV edhe në seancën e XI ka abstenuar votimin, do ta kemi të njëjtin qëndrim prapë, kështu që mundim me vazhduar me votimin. Kush është pro këtij vendimi, kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Kush është kundër kësaj pike të rendit të ditës? Kush është abstenim? Konstatoj që me 21 vota pro, me 0 kundër edhe 3 abstenim, kalon pika e katërt e rendit të ditës. Para se të kalojmë te eventuale, i kemi të dy rekomandimet që i kanë bo në takimin u dakorduar ju, domethënë grupet parlamentare mes vete. E patëm propozimin e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe propozimin e grupit parlamentar të LVV-së. Atëherë i hedhim në votim të dy rekomandimet...në rregull, po e kërkon fjalën zoti Nedžmidin Sejdlar.

**Nedžmidin Sejdlar:** Kolegu Jetmir bëri një propozim perfekt, që të ndihmojmë qytetarët dhe t'u falim 100 euro në emër të tatimit në pronë. Ne po kërkonim një mënyrë për ta zgjidhur këtë dhe për të qenë në përputhje me ligjin. Pika e mëparshme e rendit të ditës tregoi qartë se ne këtu në Kuvend mund të marrim një vendim të tillë. Ministria e ktheu në rishqyrtim vendimin që e morëm pak më parë. Që ne si këshilltarë dhe përfaqësues legjitimë të popullit të marrim një vendim për të liruar qytetarët tanë nga tatimi në pronë për 100 euro. Ky është një variant. Një tjetër mundësi është që të takohemi me qytetarët tanë, që të gjithë të jenë të kënaqur dhe Ministria e Financave të jetë e kënaqur dhe qytetarët tanë, sepse këtu mund të marrim një vendim që në emër të pagesës së tatimit në pronë të subvencionojmë objektet tona me 100 euro. Nuk ka asnjë problem ligjor atje. Kuvendi merr vendim dhe subvencionon çdo familje nga 100 euro në emër të pagesës së tatimit në pronë. Drejtori juaj mburret vazhdimisht se kemi shumë para dhe donatorë, por kur duhet të

shpenzojmë pak euro nuk kemi para. Ne kërkojmë që këtu të merret një vendim për subvencionimin e ndërtesave deri në 100 euro. Për të marrë vendimin për pagesën e këtyre subvencioneve, nuk do të jetë një shumë e madhe në përfundim. Kam dhënë dy module, në modelin e parë, nëse ministria na e kthen vendimin, do ta konfirmojmë sërish. E kemi vërtetuar nga praktika që ministrinë tërhiqen për herë të tretë. Ne do të subvencionojmë vetëm ata qytetarë që kanë borxhe në tatimin në pronë, kjo nuk do të thotë se nëse dikush ka vetëm 17 euro borxh, do t'i japim më shumë para.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Sejdlar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim propozimet në ni pako, në fakt dy rekomandimet të cilat janë diskutue edhe janë marrë vesh në zyrën e kryetarit. Kush është pro këtyre rekomandimeve? Kush është kundër? Abstenim nuk pat. Faleminderit, me 25 vota pro, me zero kundër dhe zero abstenim, kalon propozimi i LVV-së edhe propozimi i drejtorit për Ekonomi dhe Financa. Sidoqoftë, vazhdojmë me pikën e fundit, e kemi pikën eventuale, fjalën e ka kërkuë zoti Sefidin Mejzini nga LDK.

#### Pike V

**Sefidin Mejzini:** Kryesues faleminderit për fjalën! Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar, kam ni kërkesë për ty, ka pas ni reagim nga Dega e PDK-së, sa e pashë më datën 28, për angazhimin e disa, e dy specialistëve në QKMF, domethënë është mirë, për hir të opinionit me na dhënë ni sqarim, ni shpjegim si qëndron situata. Normal, jemi në demokraci, janë gjëra që edhe ndodhin, kështu që është mirë për hir të opinionit ta japësh ni sqarim, çfarë është e vërteta, çfarë ka ndodhë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, zotëri Mejzini! Fjalën e ka kryetari.

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit, Sefë! Ju përshëndes edhe ni herë! Është e vërtetë që Dega e PDK-së në Dragash, në uebfaqen e tyre ka bo ni reagim, edhe unë së pari ju kërkoj falje asambleistëve të PDK-së, të cilët janë këtu, për të cilët kam shumë respekt, edhe kam ni vlerësim që gjithmonë në Asamble kanë qenë konstruktivë. Po megjithatë, për hir të informimit të drejtë të opinionit, unë me kërkesë të anëtarësisë jam i detyruar, edhe pse nuk po më pëlqen, që të jap disa sqarime lidhur me këtë reagim. Është punë e opozitës që të kontrollojë punën e pozitës, punën e kryetarit, edhe mirë atë që e bon se e bon edhe për anëtarësinë e vet, mirëpo nuk është mirë me shpif edhe me paragjyke. PDK-ja kanë reague për dy çështje, për angazhimin e ni doktoreshe në QKMF, edhe për angazhimin e dy specialistëve, të cilët janë duke punue ni herë në javë në QKMF-Dragash. Ju e dini që problemi i gjinekologut është ni problem i kahmotshëm, që e ka përcjellë qeverinë e kalume, po më përcjell edhe mu, edhe qeverinë tonë. Bile, bile, për këtë çështje ka debatue edhe Kuvendi i Kosovës. Ju e dini që doktor Fehmi Bojaxhiu ka qenë gjinekolog, edhe partia në pushtet e ka ditë që doktor Fehmia ni ditë do të dalë në pension, dhe duhet ta falënderojmë për punën e shkëlqyeshme që e ka bo doktor Fehmiu si gjinekolog. Por, partia në pushtet është dashtë me e ditë që, për me e prodhue ni gjinekolog, duhet së paku pesë vjet. Prandaj edhe është dashtë të shpallet konkursi për pranimin e ni mjeku, për me shkue në specializim në gjinekologji. Këtë çështje partia në pushtet, edhe pse 14 vite ka qenë, nuk e ka bërë. Edhe gjatë debateve televizive që i kemi pas me kryetarin e kaluar, këtë çështje e kemi debatue, dhe përgjigja e kryetarit ka qenë se na e kemi konkursin e hapur edhe nuk ka të interesuar. Unë atëherë i kam thonë, edhe sot po i thom se ka pas të interesuar, njëra prej atyre mjekëve të interesuar ka qenë Saime Ibrahim Sylejmani, e cila ka qenë në bisedë edhe te kryetari, edhe te drejtori i Shëndetësisë, i QKMF-së.

Dhe nuk është pranue kjo doktoreshë që t'i ndahet specializimi nga ana e ish-pushtetit. Doktoresha Saime është vendase e jona, është e martume në Prizren, e ka marrë specializimin nga gjinekologjia privat. Unë, duke marrë parasysh se ne jemi të obliguar ta gjejmë në gjinekolog, kam biseduar me doktoreshë Saimen, edhe me doktor Selamiun, edhe e kom bind që ajo të pranojë që kur ta kryjë specializimin, të na kthehet neve dhe të punojë si gjinekologe. Dhe ne atë e kemi pranuar në punë me konkurs të hapur dhe të rregullt, dhe pastaj me të kemi bo ni kontratë – marrëveshje, të cilën e ka nënshkruar vetë doktoresha, drejtori i Drejtoratit për Shëndetësi edhe drejtori i QKMF-së. Dhe në nenin 3 të kësaj kontrate shkruan: Komuna e Dragashit, nëpërmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, merr përsipër që të financojë punëmarrësen, do të thotë Saimen, specializanten në specializimin e gjinekologjisë deri në licencimin dhe përfundimin e specializimit. Obligim i punëmarrëses është që pas përfundimit të specializimit të punojë për punëdhënësin, do të thotë QKMF-Dragash, për aq vite sa do të bëhet financimi i specializimit të saj. Në rast se punëmarrësi e shkëput njëanshëm këtë marrëveshje, nuk i përmbahet kushteve të kësaj marrëveshjeje, obligohet që punëdhënësit t'i kthejë gjithë shumën e mjeteve të investuara në vlerën e pagës së mjekut në momentin e shkëputjes së njëanëshme të marrëveshjes. Këtu unë jam akuzue që unë për këtë të mirë që i kam bo doktor Selamiut, doktor Selamiu mu më ka çue në det 5 ditë në Turqi. Kjo është ajo shpifja që më ka shti me reague. Unë këtu e kam dokumentacionin, që do të thotë, shkumja në det është bo pagesa në Zvicër nga djali im. Do të thotë, ky është ni dokumentacion që e demanton thënien e PDK-së. Gjithashtu, me këtë thënie të juajën, ju e keni lëndue edhe doktor Selamiun, i cili me 1981-tën ai ka qenë mjek në QKMF- Dragash dhe nga pushteti i kaluem është dënue me burgim, për shkak se i ka përkrah demonstratat. Gjithashtu, ju e dini se doktor Selamia është një mjek human, i cili mbi 30 mijë vizita i ka bo pa pagesë, gjithashtu edhe në kohën e okupimit ka punue si mjek në ambulancën e Nënë Terezës në Prishtinë, ndoshta njo prej mjekëve i cili nuk është pague. Kështu që po më vjen keq që po duhet të reagoj në këtë drejtim, po megjithatë unë, për hir të informimit të opinionit, unë kam qenë i detyruar ta boj ni gjë të tillë. Kam bisedue me doktoresha Saimen, edhe ajo është në gjendje me i kthye ato mjete. Nëse ju si PDK mendoni që është bo gabim, do të thotë ajo i kthen mjetet, edhe nuk ka më obligim ajo që të kthehet e të punojë në QKMF-Dragash si gjinekologe. Reagimi i dytë ka qenë rreth angazhimit të dy specialistëve pensionista në QKMF-Dragash, është fjala për oftamologun edhe për neuropsikiatrin. Faktikisht, nëse merret kështu realisht, nuk janë dy specialist, por janë tre, për arsye se neuropsikiatri i kryen dy punë, edhe punën e psikiatrit edhe punën e neurologut. Tashmë nuk ka specializime, doktori e di, të neuropsikiatrisë, po ka specializime të ndame, psikiatër veç, neurolog tjetër. Kështu që komunës tonë me ni mjek po i bëhen dy shërbime. Edhe është cek që ata kanë qenë cimerat e mi. Kam bisedue me këta dy mjekë, ata janë pajtue, që do të thotë nëse ju i gjeni cimerat e juaj, i bini e i angazhoni, ju bini lirisht edhe do të punojnë ata, këta do të tërhiqen. Por unë nuk do të na lem me këtë, do të vazhdoj të siguroj edhe mjekë të tjerë, jemi në rrugë të mirë ta sigurojmë edhe gjinekologun, jemi në rrugë të mirë ta sigurojmë edhe ni internist kardiolog, i cili gjithashtu do të punojë ni herë në javë, sikur mjekët tjerë. Mjetet i kemi të siguruara, e kemi pas edhe ni vizitë të dy inspektorave, vizitë rrufe nga Qeveria për punën e këtyne, e di që planifikohet në Dragash të hapet ni qendër mjekësore, e cila do të jetë në shërbim, private po mendoj, do të jetë në shërbim të qytetarëve, por jam shumë i bindur që këta mjekë që do të angazhohen në QKMF-Dragash nuk do t'i bojnë konkurrencë kësaj qendre mjekësore private, për arsye se ata vijnë ni herë në javë dhe ni herë në javë u ofrojnë shërbime shëndetësore popullatës pa pagesë. Kurse me këtë qendrën që do të hapet së shpejti, ka mundësi të gjithë qytetarët e komunës tonë me shkue m'u vizitue, por aty duhet me pague. Tash qytetarët mund të zgjedhin, mund të shkojnë m'u vizitue me pagesë, mund të shkojnë m'u vizitue pa pagesë. Kështu që na nuk jemi si pushtet kundër hapjes së asaj qendre,

jemi pro hapjes së asaj qendre dhe çdo dokumentacion i cili do të kërkohet nga komuna, na do t'ua japim, nëse normal i plotëson kushtet, por ne edhe në fushatë elektorale kemi dhënë fjalë popullatës që prioritet, ndër prioritetë është edhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore efikase për qytetarët tonë, edhe gjithashtu që këto shërbime t'u ofrojmë qytetarëve sa më afër tyre. Do të thotë, në këtë formë na i kemi kursye qytetarët tonë që mos të shkojnë në Prizren t'i kërkojnë këto shërbime, por t'i kanë këtu në Dragash. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, kryetar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkue zoti Nexhat Selaj nga PDK.

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje edhe ni herë! Kryetar, mos e merr shumë ngat zemrës këto ankesat të cilat bohën nga opozita, nëse ka diçka të ngjashme të tillë, ne duhet që këto t'i trokasim diku, është gjykata, është prokuroria, por nëse janë ato të vërteta të cilat ju i thoni se do t'i sjellni mjekët, je për çfarëdo lavdate. Ne kemi nevojë për specialist të tillë dhe të uroj që sa më shpejt, këta mjekë specialistë të na i sjellësh, se shumë seriozisht, Qendra e Mjekësisë Familjare vuan për këto fusha të ekspertave, të specialistave të ndryshëm. Por sa i përket atyre parregullsive, ju e dini se si i mbuloni ato, është çështje e gjyqësisë edhe është e prokurorisë. Kështu që mos e merr shumë ngat zemrës këto të cilët bojnë këto reklamime, opozita e ka këtë, ju e keni dëshminë, unë prapë po thom po të uroj për punën e mbarë dhe iniciativën të cilën e keni marrë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Selaj! Fjalën e ka zoti Sejdillar dhe pas tij zoti Shpetim Hajredini.

**Nedžmidin Sejdilar:** Është e qartë se ju mungojnë drejtorët këtu dhe mendoj se keni vetëm një nga drejtorët tuaj në këtë seancë. Këtu nuk është shefi i zyrës për komunitete, i cili e ka obligim të marrë pjesë në seancat e Kuvendit. Ai nuk ka qenë këtu për dy seanca. E di që nuk do të vijnë në këto takime derisa të harrojnë ngjarjet që keni bërë bashkë. Dhe se ai, se duhet të ikë nga këtu se nuk përballët dot me faktet. Një nga gjërat që më intereson është përdorimi i veturave zyrtare në komunën e Dragashit, sipas statutit të komunës së Dragashit të drejtën e përdorimit të automjetit komunal 24 orë në ditë e keni vetëm ju zoti kryetar. Pse i dhatë menaxherit të zyrës mundësinë për të përdorur xhipin 24 orë në ditë? Ai xhip kushton 6000 euro dhe 2000 euro zhvlerësimi, propozimi im ishte shumë i lartë 50000 euro, por të paktën mund ta kishit marrë parasysh propozimin e zotit Haradinaj. Pse po harxhoni para ku nuk ka nevojë, e ku ka nevojë thoni nuk kemi para. Ne në Gorë e dimë se ky njeri shiti interesat e të gjitha komuniteteve vetëm për një xhip. Po kërkoj një përgjigje nga ju pse nga të gjithë nëpunësit komunalë vetëm kryetari i zyrës së komunitetit ka të drejtë xhip 24 orë në ditë. E kuptoj që punon shumë, por në zyrën tuaj, ndërkohë që e ka lënë pas dore fare punën e zyrës në komunitet. Komunitetet janë në një situatë katastrofike. Ai nuk është plotësisht i shqetësuar për gjendjen e komuniteteve. Ne në komitetin e komunitetit kemi një kërkesë që e kam adresuar më 26 korrik 2022, por nuk ka hyrë asnjëherë në rend dite. Ju nuk dini asgjë për këtë sepse nuk merrni pjesë në komitetet e komunitetit. Pse nuk ishte në rend dite? Kërkesa është e njëjtë me atë të qytetarëve të fshatit tuaj, të cilët kërkuan të prishim ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të ndërtojmë një park. Kryetari i komisionit gjithmonë pyet nëse ka kërkesa për komision, personi që i pëlqen 20% të tenderit gjithmonë thotë jo dhe kërkesa ulet në një fiok. Ne patëm të njëjtin rast me një njeri që u ankua te avokati publik. Pse po injorohen kërkesat e komuniteteve? Shefi i zyrës për komunitete është i obliguar që të merret me të gjitha komunitetet, shqiptare, boshnjake, gorane, dhe siç po dëgjoj tani do të formohet një komunitet tjetër e komuniteteve bullgare dhe u uroj suksese. Pyetje tjetër: pse i keni dhënë Miralem Rahtes

4000 euro në emër të një organizate joqeveritare, a e dini se ky është konflikt direkt interesi. Asnjë person politik nuk mund të jetë anëtar i një organizate joqeveritare. Emri i tij shfaqet në anëtarësimin në faqen zyrtare të internetit. Ai bëri një foto me ju në faqe kur ju morët detyrën. Janë ato fotografi në faqen zyrtare të komunës së Dragashit, nëse nuk i keni hequr deri tani. Është një konflikt i drejtpërdrejtë interesi. Si mund ta kuptojë këtë një qytetar i thjeshtë? Kur i jep subvencione atij që është ulur në të djathtën tënde dhe këtu në kuvend. Vetëm ti vazhdo kështu dhe do të vije koha kur të shohim kurrizin dhe do të vije një president me i mire, me i bukur dhe me vlere se ti dhe që do ta drejtoje pak me mire këto komune. Pyetja e tretë për presidentin: a do të na thoni emrin e organizatës joqeveritare të cilës i keni dhënë kontratë 186 mijë euro për të menaxhuar pastrimin e borës. A doni të na thoni sa të punësuar ka në atë organizatë joqeveritare, sa është proporcionaliteti i punësimit në atë organizatë, kjo është pyetje edhe për shefin e zyrës për komunitete, sa traktorë kemi në dispozicion. . Qytetarët e fshatit Dikancë dhe Baçkë më telefonuan për t'u ankuar se nuk po ua pastroni rrugën. Bora ishte 2 deri në 5 cm dhe nuk kishit kohë ta pastroni. Pse i diskriminuat ata njerëz dhe pse nuk u hapët rrugën?

**Uran Halimi:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Shpëtim Hajredini, pas tij fjalën e ka kërkuar zoti Miralem Rahte nga VAKAT.

**Shpëtim Hajredini:** Atëherë, diskutimi pat të boje me prezencën e kryetarit, e tash...

**Uran Halimi:** Po, kryetari më trgoi që, edhe para se me fillue prej pauzës, që në ora dy ka me pas ni takim me KFOR-in. Në fakt në ora dy e ka pas, po ata kanë kërkuar që ta bojnë ma herët takimin, e ka ni takim me KFOR-in Turk edhe u dashtë me shkue.

**Shpëtim Hajredini:** Nga ekzekutivi nuk besoj që e kemi najkon, kështu që nuk ia vlen mo me diskutue edhe me e vazhdue diskutimin, pa prezencën e kryetarit.

**Uran Halimi:** Mundesh fjalimin me mbajt, se i ki qytetarët, i ki mediat, i ki përfaqësuesit e grupit parlamentar...

**Shpëtim Hajredini:** Jo, përderisa nuk mund të marr përgjigje nga kryetari direkt, unë s'kom çka diskutoj ma tutje, kështu që e lomë në seancën e ardhshme e diskutoj këtë çështje...

**Uran Halimi:** Unë të premtoj që përgjigjet kryetari t'i dërgon me e-mail, ose zyra e kryetarit, mundish lirisht m'i bo pyetjet, përgjigjet do t'i sigurojmë me e-mail nga zyra e kryetarit...

**Shpëtim Hajredini:** Faleminderit për informacionin, po jo, unë kom dëshirë ta kem këtu kryetarin dhe ta marr përgjigjen direkt.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zotëri Hajredini! Fjalën e ka zotëri Miralem Rahte.

**Miralem Rahte:** Unë dua t'i mohoj deklaratat e zotit Nedzmidin, sepse askush nuk më ka dhënë asnjë euro, siç thoni ju 4000 euro. Ato mjete janë dhene në emer të OJQ-se, pra organizatat joqeveritare, që. Unë jam themelues i asaj organizate joqeveritare, por nuk jam anëtar i asaj organizate. Pra, zotëri, Nedzmedin, ju vetëm po shprehni gënjeshtër në këtë kuvend, jeni duke u manipuluar popullatën, të gjitha deklaratat tuaja nuk janë të sakta dhe të gjitha këto mund të

verifikohen lehtësisht. Pra, ky është mohimi im. Së pari kontrolloni me kujdes dhe më pas bëni deklaratat tuaja.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zotëri Rahte! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë ni minutë replikë e ka zoti Sejdiç.

**Nedžmidin Sejdiç:** Zoti Rahte, askush nuk pret që macja të pranojë se ka ngrënë mish, ndaj nuk pres që edhe ju të pranoni që keni marrë para. Dhe nuk thashë që ti i ke marrë lekët. E kisha fjalën për konfliktin e interesit. Unë thashë se kryetari i komunës i ka dhënë 4000 euro organizatës suaj joqeveritare dhe ju jeni anëtar i së njëjtës organizatë joqeveritare dhe emri juaj është ende në dokumente. Dhe pastaj thua se po mashtron popullin. Në faqen e internetit, ju jeni ende themelues i asaj organizate joqeveritare. Sapo pyeta se me çfarë kriteresh ju ka dhënë kryetari i komunes 4000 euro për konflikt interesi. Shpjegoni pse nuk e paraqitët këtë kërkesë në komitetin e komunitetit. Shpjegoni se kush po mashtron publikun këtu

**Miralem Rahte:** Zotëri, ju keni thënë drejtpërdrejt se presidenti i ka dhënë Miralemit 4000 euro dhe e përmendët disa herë që nuk keni thënë se i ka dhënë organizatës në të cilën jam unë. Siç thoni ju. Unë jam vetëm një nga themeluesit. Unë nuk jam anëtar i asaj organizate. Ajo organizatë ka marrë 4000 euro sepse ka organizuar projektin “Ditët e diasporës në Brod”, që ka qenë një projekt i mirëorganizuar dhe nuk e di se cili është problemi. Ndoshta problemi është se kjo organizatë funksionon mirë, organizata të tilla janë organizata të rralla që punojnë dhe është një nga më të mirat në territorin e komunës së Dragashit dhe unë jam krenar që jam një nga themeluesit e asaj organizate joqeveritare.

**Uran Halimi:** Faleminderit, zoti Rahte! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë e shpalli këtë seancë të mbyllur. Faleminderit për vëmendjen!

*Kryesuesi i Kuvendit: Uran Halimi*

---